REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 24.10.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte, **më datë 31.10.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.08.2025 dhe 15.09.2025.
4.Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë Këshillit Bashkiak Maliq *"Mbi dhënien e mandatit të këshilltarit z.Selami Muço"* pas vakancës të krijuar.
5. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2025";
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
7.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.V.A banues në Maliq dhe znj.D.Z banuese në fshatin Strelcë NJ.A Gorë, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
8.P-V "Për detajim fondi sipas aktit normativ datë 08.10.2025";
9.P-V " Për konfirmimin e inventarizmit në mënyrë të gabuar të pasurive nr.109/47, z.k.2984, fshati Plasë, në listën e inventarit të proneve të transferuara me VKM nr.1154, datë 13.08.2028 *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan, të Qarkut të Korçës*";
10.P-V "Për miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rëneve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr.778, z.k.2445, fshati Libonik, NJ.A Libonik, në vendodhjen e re, në pasurinë nr.114/80, z.k.2445, fshati Libonik NJ.A Libonik";
11.P-V "Për miratimin në parim të një ndryshimi në sistemin *"ALFIS"* të ekonomisë pyjore Mesmal";
12.Diskutime të tjera.

Të tjera pika informuese:

- Analiza e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për 8-mujorin e vitit 2025
- Prezantimi i Raportit të performancës të Bashkisë Maliq për vitet 2023, 2024.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e Enjte me datë 30.10.2025 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pikat 5, 6 e rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat: 8, 9 e rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 7 e rendit të ditës: z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Yllson Ibrahimllari.

Komisioni Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pika 4 e rendit të ditës: znj.Pranvera Begolli, z.Petrit Kupe, znj.Krisitina Malelli, z.Yllson Ibrahimllari, znj.Eglantina Balli.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 10 e rendit të ditës: z.Idlir Limllari, z.Eriseld Jonusllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholli,

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedist dhe Biodiversitetit. Pika 11 e rendit të ditës: z.Lulëzim Hoxhaj, znj.Marianthi Avrami, znj.Rovena Terolli, z.Fevri Sherifi, znj.Albina Xhejo.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI